



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 428prot

Tiranë, më 22.072026

VENDIM

Nr. 8 datë 22.07 2026

PËR
MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 21/7/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 21.7.2026 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për përmbajtjen dhe formën e regjistrit elektronik të koncesioneve dhe partneritetit publik privat”, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Të jetë e shprehur qartë në projektvendim që regjistri do të menaxhohet nga “Institucioni” ku përmendet vetëm faqja zyrtare e agjencisë së trajtimit të koncesioneve dhe jo emri i i agjencisë e cila do ta menaxhojë këtë regjister.
2. Për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për vlerësimin, dhënien,

ndryshimin dhe transferimin e kontratave të koncesionit partneritetit publik privat”, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Rregullorja është hartuar në zbatim të Ligjit për PPP, i cili parashikon se Këshilli i Ministrave miraton rregullat për kontratat e PPV. Ndryshe nga institucionet qendrore, bashkitë mund, por nuk janë të detyruara, t’i kërkojnë institucionit përgjegjës për koncesionet (ATRAKO) të kryejë studimin e fizibilitetit. Ato kanë të drejtë ta zhvillojnë atë vetë ose të kërkojnë ndihmë duke dorëzuar materialet dhe të dhënat paraprake të mbledhura
- 3. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave” Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore” të ndryshuar** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Ndryshimi (pika 11/pika 2.1 e re në Kreun I) dhe pika 28 (pika 3.2 e re në Kreun V), sugjerohet që zgjerimi i enfiteozës përtej listës së Komitetit të Investimeve dhe përfshirjes së zonave të mbrojtura janë ndryshime thelbësore që do duhen konsultuar më gjerë jo vetëm me pushtetin vendor por dhe me palë të tjera të interesuara;
 - Pika 2.1 në Kreun 1, parashikon vendimet e Komitetit të Investimeve janë marrë (në të shkuarën) dhe nuk priten vendime të reja. Sugjerohet që kjo pikë të jetë një dispozitë kalimtare meqë do të ketë një efekt të kufizuar dhe të përcaktohet afati i vlefshmërisë
- 4. Për projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes” të ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Inovacionit bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
- 5. Për projektvendimin “Për një ndryshim dhe disa shtesa në vendimin nr. 466 datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave” Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit të Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit” i ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
- 6. Për projektvendimin “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030”,** propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Në dokumentin 1.2 Agjenda për të Drejtat e Fëmijëve, në pikën II.4.3.a, të faqes 90, të rishikohet riformulimi i kësaj pike, pasi nuk mund të zhvillohen procedura të veçanta vetëm për konfidencialitetin pasi një ndër parimet e punës së strukturave të policisë është ruajtja e konfidencialitetit.

7. **Për projektvendimin “Për masën e pagesës për familjen kujdestare dhe për fëmijët e vendosur nën kujdesin alternativ në familje”,** propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
8. **Për projektvendimin “Për organizimin, funksionimin, dhe aksesin në regjistrin elektronik për kujdesin alternativ në familje”,** propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
9. **Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026-2030”,** propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
10. **Për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit, ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të saj, si dhe modelit të certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit”,** propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Pas pikës 9 të shtohet edhe paragrafi si vijon: “Përjashtimisht nga sa më sipër, deklarata paraprake, leja e zhvillimit dhe leja e ndërtimit, lëshohen nga KKTU-ja, nëse zona ku do të ndërtohet bën pjesë në brez bregdetar, sipas përcaktimeve të Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” referuar nenit 28 dhe 41 të Ligjit 107/2014, i ndryshuar;
 - II. pika 10, gërma (d) dhe (dh). Të riformulohet si vijon: “Në rast se, nga verifikimet në terren, rezulton se propozimi është në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe me dokumentet e planifikimit të territorit në fuqi, KKTU-ja/kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr vendim për miratimin e lejes së ndërtimit. Kur për zbatimin e lejes së ndërtimit kërkohet ndryshimi i kategorisë së përdorimit të tokës në “truall”, Sekretariati Teknik i KKTU-se/njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet kërkesë ministrisë përgjegjëse për turizmin, e cila në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë bazuar legjislacionit në fuqi, ndjek procedurën dhe përgatit projektvendimin për miratim në Këshillin e Ministrave.” referuar nenit 28 dhe 41 të Ligjit 107/2014, i ndryshuar;
 - III. pika 1. gërma (a). Të riformulohet: Lejen e zhvillimit ose aktin përkatës të miratimit të zhvillimit të strukturës, ku parashikohet ushtrimi i veprimtarisë së agroturizmit, së bashku me planvendosjen e miratuar nga KKTU-ja/njësisë së vetëqeverisjes vendore, fragmentin e hartës kadastrale dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;
 - III. pika 5, gërma (i). Përpara “kartelës së pasurisë” të shtohet edhe “Certifikata e pronësisë”;

- III. pika 5, gërma (v) të riformulohet “Vertetimin e Pronësisë”;
 - IV. pika 4, gërma (f), të parashikohet opsioni i zëvendësimit të anëtarit që gjendet në kushtet e konfliktit të interesit;
 - V. pika 1, gërma (a), të riformulohet si vijon: Pas “inspektoratit përgjegjës për turizmin” të shtohet edhe “inspektorati përgjegjës për territorin, mjedisin dhe pyjet”;
 - Përfshirja e përfaqësuesve të NJVV-së në Komisionin e Certifikimit. Komisioni i Certifikimit të Agroturizmit (Kreut IV, pika 2) përbëhet nga 5 anëtarë: 3 nga Ministria e Turizmit dhe 2 nga Ministria e Bujqësisë. Pushteti vendor mbetet tërësisht i papërfaqësuar, ndonëse është autoriteti që njeh territorin, planifikimin vendor dhe miraton lejet e ndërtimit. Të shtohet në komision të paktën 1 anëtar/përfaqësues nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse ose nga Shoqata e Bashkive, për të garantuar vendimmarrje më reale dhe të mirëkoordinuar me planin vendor të zhvillimit;
 - Qartësimi dhe lehtësimi i procedurave kur mungon Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV): Kreu II, pika 10 parashikon një procedurë komplekse me shumë hapa ndërmjet Bashkisë, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT) dhe Ministrisë së Turizmit për kontrollin e përputhshmërisë. Gjithashtu, ndryshimi i kategorisë së tokës në "truall" kërkon vendimmarrje të posaçme nga Këshilli i Ministrave;
 - Të përcaktohen afate kohorë për AZHT-në (shumë hapa në pikën 10 nuk kanë afat të caktuar ditësh) për të shmangur burokratizimin dhe vonesat për aplikuesit ruralë. Të delegohen më shumë kompetenca te bashkitë për ndryshimin e përdorimit të tokës bujqësore për agroturizmin kur investimi është i miratuar në parim;
 - Koordinimi i kontrollit dhe monitorimit në terren (Kreu IV, pika 12 & Kreu V, pika 1): Projektvendimi ngarkon Inspektoratin e Turizmit, organet tatimore dhe ato të sigurisë ushqimore për monitorim, ndërsa pranon që njoftimet për shkelje mund të vijnë edhe nga bashkitë. Sidoqoftë, nuk ka një protokoll të qartë të inspektimit të përbashkët. Të krijohet një mekanizëm koordinues ose grup i përbashkët inspektimi (me pjesëmarrjen e policisë bashkiake / inspektoratit vendor), në mënyrë që bashkitë të kenë informacion të menjëhershëm për statusin e agroturizmave në territorin e tyre dhe të dërgojnë njoftime zyrtare pranë Komisionit;
 - Rregullimi i Mbledhjes dhe Rikuperimit të Taksave Vendore (Kreu V, pika 8): Pika 8 e Kreut V përcakton se shfuqizimi i certifikatës detyron subjektin të kthejë grantet dhe përfitimet/reduktimet e taksave vendore;
 - Të detajohet procedura se si njoftohet bashkia për shfuqizimin e certifikatës, duke i dhënë të drejtën ligjore organit tatimor vendor që të vjelë menjëherë diferencën e taksës lokale (p.sh. taksën e ndërtimit apo taksën e ndikimit në infrastrukturë) për periudhën që subjekti ka përfituar jashtë kriterëve.
- 11. Për projektudhëzimin “Për caktimin e kriterëve për përpilimin e listave, mënyrën e hartimit të skedave përshkruese për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore objekt verifikimi të interesit kulturor dhe dërgimit të tyre”** propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Zgjerimi i afatit 10-ditor për plotësimin e dokumentacionit;
 - Neni 9 (pika 5 dhe 6) parashikon se nëse dokumentacioni i dërguar nga institucioni administrues (si bashkia) ka pasaktësi, IKTK lë vetëm 10 ditë pune afat për plotësim. Nëse afati shkelet, procedura mbyllet automatikisht dhe duhet riaplikuar nga e para. Afati prej 10 ditësh pune është tepër i ngushtë për bashkitë, veçanërisht kur kërkohen certifikata kadastrale, verifikime teknike në terren ose kërkime arkivore. Rekomandohet që ky afat të zgjatet në 20 deri në 30 ditë pune, ose të lejohet shtyrja e tij me kërkesë të arsyetuar nga bashkia;
 - Integrimi automatik me Regjistrin e Pronave të Bashkisë dhe Kadastrën;
 - Neni 6 dhe Neni 9 kërkojnë që bashkia të sigurojë dokumentacion kadastral, hartografik dhe koordinata gjeografike (KRRGJSH). Për të shmangur vonesat dhe kosto administrative, të parashikohet unifikimi digjital ndërmjet Bazës së të Dhënave të Trashëgimisë (RKPK) dhe sistemit të Kadastrës (ASHK) e platformës GIS vendore. Informacioni kadastral dhe hartografik duhet të gjenerohet automatikisht ndërinstitutionalisht pa ia ngarkuar barrë shkresore bashkisë.
 - Përfshirja e "Komunitetit Lokal" dhe Trupës Vendore në Kriteret e Propozimit;
 - Neni 4 përcakton kriteret se cilat pasuri përfshihen në listë (si mosha mbi 70-vjeçare, vlera historike, etj...). Të shtohet si kriter i veçantë “Iniciativa ose kërkesa nga Këshilli Bashkiak, komuniteti lokal apo organizatat e shoqërisë civile të zones”. Kjo do t'i jepte zë pushtetit vendor për të mbrojtur objekte me identitet të fortë shpirtëror e lokal, edhe nëse ato nuk janë të evidentuara zyrtarisht në arkivat qendrore.
 - Selia e qartë e Pronësisë pas deklarimit “Pasuri Kulturore”;
 - Neni 9 (pika 7) përcakton se pas miratimit nga Ministri, objekti regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore, por udhëzimi nuk sqaron se çfarë ndodh me tagrin e administrimit/pronësisë dytësore për pasuritë që janë të vetë bashkisë. Të shtohet një pikë e qartë që specifikon se deklarimi i një pasurie shtetërore vendore si “pasuri kulturore” nuk i heq të drejtën e pronësisë apo administrimit Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore, duke i garantuar bashkisë të drejtën primare për ta përdorur atë për qëllime kulturore, muzeale apo turizëm lokal.
- 12. Për projektvendimin “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i prodhimit të ujit” Sh. a dhe përcaktimin e rregullave për organizimin, periudhën tranzitore dhe fillimin e veprimtarisë së saj”** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Përcaktimi i metodologjisë së çmimit të shitjes me shumicë të ujit;

- OPU sh.a. do t'u shesë ujin me shumicë operatorëve të shpërndarjes (që janë në pronësi/varësi të bashkive). Ekziston rreziku që vendosja e tarifave të larta nga OPU sh.a. të rrisë tarifat përfundimtare për qytetarët ose të çojë në falimentim ndërmarrjet ujësjellës-kanalizime të bashkive. Të shtohet një garanci që tarifa e shitjes me shumicë të ujit nga OPU sh.a. të shoqëritë rajonale/vendore duhet të rregullohet rreptësisht nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU), duke vendosur tavane mbrojtëse që mos ngarkohet konsumatori lokal.
- Menaxhimi i borxheve dhe detyrimeve historike gjatë transferimit të aseteve;
 - Pikat 19 dhe 21 ngarkojnë shoqëritë rajonale ekzistuese të inventarizojnë dhe transferojnë asetet dhe kontratat tek OPU sh.a., ndërsa pika 20 specifikon se detyrimet mbeten të shoqëritë rajonale deri në transferim. Ekziston rreziku që OPU sh.a. të marrë vetëm asetet “e pastra” dhe t'u lërë bashkive borxhet e prapambetura (p.sh. detyrimet e energjisë elektrike të stacioneve të pompimit). Të parashikohet se transferimi i aseteve shoqërohet automatikisht me marrjen përsipër ose pastrimin e detyrimeve/borxheve financiare historike që lidhen drejtpërdrejt me ato asete prodhimi nga ana e OPU sh.a. ose Buxhetit të Shtetit.
- Garancia e stafit teknik dhe e të drejtave të punëmarrësve;
 - Pika 19/e përmend se transferimi i burimeve njerëzore realizohet sipas marrëveshjeve mes palëve, por njëkohësisht OPU sh.a. ka të drejtë të rekrutojë staf të ri. Kjo mund të çojë në largime masive nga puna të specialistëve lokal. Të garantohet kalimi automatik i të gjithë stafit teknik ekzistues (inxhinierë, hidraulikë, operatorë stacionesh) që punojnë në vendburime e stacione pompimi të OPU sh.a duke ruajtur të drejtat e tyre të punës, vjetërsinë dhe nivelin e pagave.
- Rritja e afatit tranzitor nga 12 muaj dhe përfshirja e bashkive në auditim;
 - Periudha tranzitore prej 12 muajsh (pika 10) është tepër e shkurtër për kryerjen e inventarizimit fizik, juridik dhe kadastral të të gjitha burimeve uji në shkallë vendi. Rekomandohet që procesi i inventarizimit dhe auditimit të bëhet përmes Komisioneve të Përbashkëta Teknike (Bashki - OPU sh.a.) me një afat më të përshtatshëm (p.sh. 18-24 muaj) për të shmangur konfliktet mbi pronësinë e tokës dhe infrastrukturës përcjellëse;
 - Në pikën 5, të sqarohet qartë kufiri ndërmjet prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, meqënëse shpërndarja (sipas relacionit) do të bëhet nga operatorët rajonal, si dhe të shtohet shprehja që Sh. a nuk ushtron veprimtarinë e shpërndarjes së ujit tek konsumatorët fundorë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi;

- Të shtohet paragrafi; Sh.a ushtron veprimtarinë e saj mbi bazën e parimeve të efikasitetit ekonomik, transparencës, qëndrueshmërisë financiare dhe garantimit të sigurisë së furnizimit me ujë të pijshëm.

Z. Ervin DEMO
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor



Z. Aldrin DALIPI
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë

